

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR “10 Ten”shpk

Në **Tiranë**, sot më datë 19.05.2023, unë i poshtëshënuari:

Ariel Tuci i biri i Gegës, i datëlindjes 10/091997, lindur në Bisakë/Mirditë dhe banues në Itali i identifikuar me kartë identiteti italiane numër CA 436430N me cilësinë e “ortakut themelues” deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, **“10 Ten” shpk**,

Neni 1
Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin **“10 Ten”**, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka seline në adresë: Rrashbull/Durrës.

Neni 4
Objekti i veprimitarisë

Objekti i veprimitarisë së shoqërisë do të jetë:

“Tregti me pakice artikuj ushqimore. Import - eksport, tregtimin e artikujve te ndryshme te te gjitha llojeve me shumice dhe pakice si tregtim artikuj te ndryshem industriale, blegtoral, fruta perime, tregtim konfeksione te llojeve te ndryshme”

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 1000 (njëmijë) lekë, në një kuotë të vetme zotërohet si më poshtë:

Ariel Tuci , zotëron 1 kuotë me vlerë 1000 (njëmilë) lekë, e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk

mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9
Administrimi

Administrator i shoqërisë është:

Ariel Tuci, i datëlindjes 10.09.1987, lindur në Bisakë/Mirditë e banues në Itali, identifikuar me dokument identifikimi me nr CA 436430N, emëruar ne këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtritje.

Neni 10
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik në Republiken e Shqipërisë.

Neni 11
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera te njëjta juridike.

Akti i mësiperm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare "10 Ten" shpk , nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKËT THEMELUES

Ariel Tuci

